



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 17 shkronja o) dhe nenit 40 pika 40.2 shkronja i) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.8 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.15 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.08.2022 miraton këtë:

## V E N D I M

### Për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave në komunën e Rahovecit

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/2580/22, i datës: 09.08.2022 për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave në komunën e Rahovecit.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, ku 3 (tre) anëtarë janë nga Kuvendi i Komunës dhe 2 (dy) anëtar janë nga ekzekutivi i komunës, si në vijim:
  - 2.1. Arber Zenuni - anëtar nga Kuvendi i Komunës - AAK;
  - 2.2. Ilir Pallqa - anëtar nga Kuvendi i Komunës - LVV;
  - 2.3. Eqrem Spahiu - anëtar nga Kuvendi i Komunës - LDK;
  - 2.4. Almir Mullabazi - anëtar nga ekzekutivi i Komunës;
  - 2.5. Nora Boshnjaku - anëtar nga ekzekutivi i Komunës.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë që të përcaktoj emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave në Komunën e Rahovecit sipas kushteve, kriterëve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi dhe akteve tjera nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Obligohet komisioni që me konsensus të brendshëm të anëtarëve të përzgjedh kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVEC

01 Nr.362/22  
Datë: 30.08.2022

